

# “PERDE KARTERI” SHPK

## AKT THEMELIMI

PER

### SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

Themeluesit kanë vendosur të krijojnë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar sot më datë 10/01/2024 në bazë të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “PER TREGTARET SHOQERITE TREGTARE”, në bazë të kushteve që vijnë;

*Themelues:*

1. Z. Ganian Karteri, atësia Pëllumb, lindur në Berat, më datë 31.07.1985, dhe banues në adresën Rruga Tish Dahia, Kompleksi “Kika”, godina C8, kati 5e, Tiranë, Shqipëri, me Kartë Identiteti Nr. 033895111 dhe Nr. Personal I507310200.

#### *NENI 1*

Ganian Karteri do të krijoj një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, të cilën do ta quajmë: “PERDE KARTERI” Sh.p.k., e cila do të ketë si objekt:

- 1- Qepje perdesh.
- 2- Tregëti me pakicë e shumicë të perdeve, pëlhurave, tekstile dhe grilave.
- 3- Import – Eksport i të gjitha llojeve dhe formave.

Shoqëria mund të ushtrojë gjithashtu edhe aktivitete të tjera ndihmëse në përputhje me legjislacionin në fuqi, të konsideruara me përfitim si dhe të dobishme për arritjen e objektivave të saj kryesore. Shoqëria ka të drejtë të bashkëpunojë me persona fizikë, juridikë, me çdo shoqëri tjetër, brenda dhe jashtë vendit.

#### *NENI 2*

Shoqëria e ka selinë në Tiranë, Shqipëri në adresën : Rruga Medar Shtylla Komuna e Parisit, Kulla 2, Pozicioni B, Zonë Kadastrale 8260, Tiranë.

Shoqëria do të ketë adresë sekondare në: Rruga “ Myslym Shyri “ , Pallati 60, Shk.5, Ap.22, Nr.Pasurie 4/155+5-62, Zonë Kadastrale 8250.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

*NENI 3*

**KOHEZGJATJA** Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore pa afat.

*NENI 4*

**KAPITALI THEMELTAR** i shoqërisë është 100.00 (njëqind) lekë.

Kapitali i mësipërm është nënshkruar nga “ortaku“ i shoqërisë:

- 1- Z. Ganian Karteri, zotërues i 1 kuote, me vlerë nominale 100.00 (njëqind) lekë dhe me vlerë të përgjithshme 100.00 (njëqind) lekë, që përbën 100.00 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Ortakët përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

*NENI 5*

Administrator i shoqërisë do të jetë:

1. Z. Ganian Karteri, atësia Pëllumb, lindur në Berat, më datë 31.07.1985, dhe banues në adresën Rruga Tish Dahia, Kompleksi “Kika”, godina C8, kati 5e, Tiranë, Shqipëri, me Kartë Identiteti Nr. 033895111 dhe Nr. Personal 1507310200, emëruar në këtë detyrë për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtëritje.

*NENI 6*

Shoqëria do të rregullohet përveç këtij Akt Themelimi, edhe me norma të përcaktuara në një Statut, i cili do të nënshkruhet nga ortakët e shoqërisë dhe si i tillë do të fitojë personalitetin juridik me rregjistrim në “Qendrën Kombëtare të Bisnesit” në bazë të Ligjit 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Bisnesit “ i ndryshuar, ditën kur shoqëria do të legalizohet si person juridik shqiptar.

**ORTAKET E SHOQERISE**

**“PERDE KARTERI “ SHPK**

**GANIAN KARTERI**

